

Dt. 20/11/2020

**STATUTI I SHOQËRISË  
“AGRO IMSHTA” sh.p.k**

**Neni 1**

-Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “**AGRO IMSHTA**” sh.p.k, u krijua sot ne date 20/11/2020, në bazë të aktit të themelimit te datës 20/11/2020 nga:

**1- Z. Ardjan Çitozi**, atesia Besim, i dtl. 01/02/1976, lindur ne Kruje, ALB dhe banues ne Rashbull, Durres, me zotësi te plete juridike për te vepruar, identifikuar me leternjoftim nr. 032715472 dhe me nr. personal J70622106O,

**2-Z. Regont Beqiri**, atesia Bashkim, i dtl. 27/02/1989, lindur dhe banues ne Imshte, Lushnje, me zotësi te plete juridike për te vepruar, identifikuar me leternjoftim nr. 035879337 dhe me nr. personal I90227025F dhe

**3-Z. Valter Ndreca**, atesia Fran, i dtl. 28/08/1985, lindur ne Kaçinarë, Mirditë dhe banues ne Laç, me zotësi te plete juridike për te vepruar, identifikuar me leternjoftim nr. 035148322 dhe me nr. personal I50828082T.

**Neni 2**

Shoqëria është person juridik shqiptar.

Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjisacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentet themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

**Neni 3**

**Forma e shoqërisë**

Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Kjo shoqëri e këtij lloji do të përballojë humbjet e saj deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj të paraqitur në këtë statut.

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”.

**Neni 4**

**Emërtimi tregtar**

Emri tregtar i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar është “**AGRO IMSHTA**” sh.p.k

**Neni 5**

**Zyra Qendrore**

Zyra Qendrore e shoqërisë do të jetë në Fshati Imshte, prane shkolles se vjeter, Njesia Administrative Bubullime, bashkia Lushnje, ne pasurine e regj. ne DVASHK Lushnje, me nr. pasurie, nr. pasurie 196/56, në ZK 1984, vol. 6 fq. 92.

Dt. 20/11/2020

Me vendim të Ortakëve kjo zyre e shoqërisë mund të ndryshohet, të hapen filiale dhe përfaqësi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**Neni 6**  
**Objekti i veprimtarisë**

Shoqeria tregtare “**AGRO IMSHTA**” sh.p.k

ka si objekt veprimtarie:

-Prodhimin dhe tregtimin ne Shqiperi dhe jashte saj te produkteve ushqimore bimore bujqesore dhe te pyllit (te egra) per qellime ushqimore,mjeksore si dhe kozmetike. Te produkteve me origjine shtazore dhe produktet qe derivojne nga to qofshin keto blektorale apo te egra.Zhvillimin e procesit te perpunimit ,transformimit ruajtjes dhe amballazhimit te produkteve te siperpermendura dhe produkteve qe derivojne nga to me origjine shtazore apo bimore duke i konsideruar nga pikepamja me e gjere e mundeshme.Aktivitetin e import-eksport.Dhenien e konsulences,ndermjetesimit, dhe tregtimit per shoqeri shqiptare apo te huaj,brenda territorit shqiptar ose jashte tij.

**Neni 7**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar, dhe do të fillojë nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendoset me vendim te Asamblesë se Ortakeve.

**Neni 8**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali i shoqërisë do të jetë 100000 (njëqind mijë) Lekë, i zotëruar nga tre ortaket: **1-Ardjan Çitozi, 2-Regont Beqiri, 3-Valter Ndreca, te sipershenuar.**

Ky kapital është i ndarë në 3 (tre) kuota, nga te cilat dy me vlerën 33 (tridhjete e tre mijë) Lekë te cilat zoterohen nga ortaket **Regont Beqiri dhe Valter Ndreca** dhe një kuote me vlerë 34 (tridhjete e kater mijë) Lekë e cila zoterohet nga ortaku **Ardjan Çitozi**.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë te nivelit te dyte në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

Ne rast ndryshimi te përbërjes se Asamblesë se Ortakeve dhe kapitali shoqerise do te zotërohet nga me shume se një person, kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Në rastin kur një ortak do të tjetërsojë kuotat që ai zotëron në kapitalin themeltar, ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së tyre proporcionalisht me kuotat që ata zotërojnë.

Dt. 20/11/2020

Kuotat e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin paraprak te ortakut tjeter.

### Neni 9

#### Asambleja e Përgjithshme

Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve ne mbledhjet e tyre përkatëse. Ortakët lajmërohen me shkrese, të paktën 7 ditë përpëra mbledhjes së Asamblesë. Njoftimi duhet të përmbajë: ditën, orën, vendin ku do të mbahet mbledhja; si dhe rendin e ditës.

Lajmërimi bëhet nga administratori ose në mungesë të tij nga një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5 % të kuotave të kapitalit themeltar nëpërmjet kërkesës me shkrim drejtuar administratores.

Asambleja e Përgjithshme e thirrur në mënyrë të parregullt, mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese te gjithë ortakët janë dakord per te marre vendime pavaresisht parregullsise.

Asambleja e ortakëve duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda tre muajve nga mbyllja e periudhës ushtrimore apo sipas rasteve te parashikuara ne ligj.

Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë, apo edhe në një vend tjetër, i cili u bëhet i ditur paraprakisht ortakëve.

Në mbledhjet e Asamblesë vendimet merren me shumicen e votave te ortakeve pjesëmarrës, me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligjin "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Në rast se Asambleja e Pergjithshme do të vendosë për:

- 1- Ndryshimin e statutit;
- 2- zmadhimin, apo zvogëlimin e kapitalit;
- 3- të kaluar në likujdim të parakohshëm shoqërinë, ose për të zgjatur afatin
- 4- shperndarjen e fitimeve

atëherë vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 65% kuotave të kapitalit themeltar.

### Neni 10

#### Kompetencat e Asamblesë

Asambleja e Pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine ne lidhje, perfshire por pa u kufizuar, ne çeshtjet e me poshtme:

- Te përcaktoje politikat tregtare te shoqërisë;
- Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej tij;
- Të japë aprosim (ose refuzoje) për çdo veprim financiar që mund të kryhet nga administratori në vlerën mbi 1.000.000 (nje milion) lekë.
- Te vendose për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- Te vendose për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë

Dt. 20/11/2020

- Të ushtrojë të drejta të tjera që parashikohen në ligjin Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”
- Te emeroje dhe shkarkoje administratorin e shoqerise.
- Te vendose per shperndarjen e dividentit.

## **Neni 11** **Administrimi i shoqërisë**

Shoqëria administrohet nga një administrator i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i shoqërisë do të jetë **Z. Regont Beqiri** i cili është zgjedhur nga Asambleja themeluese e shoqërisë. Afati i ushtrimit të detyrës nga administratori është 5 vjet me te drejte ripërtëritje. Detyra e administratorit përfundon me mbarimin e afatit 5 vjeçar, nëpërmjet shkarkimit me vendim te ortakeve qe perfaqesojne shumicen e zakonshme, dhe kur vete administratori jep dorëheqjen vullnetarisht. Administratori do te perfaqesoje shoqerine prane çdo institucioni publik apo privat per te kryerte gjithe veprimet e administrimit te shoqërisë.

## **Neni 12** **Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit**

- Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare te shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përashtim të kompetencave që ligji ua kufizon atyre apo iu jep shprehimi i shpeshish ortakëve;
- Të kryeje çdo veprim finansiar deri në vlerën 1.000.000 (nje milion) lekë
- Të emërojë dhe të shkarkojë nga puna punëmarrësit e shoqërisë,
- Të japë urdhra dhe udhëzime punëmarrësve dhe të vendosë sanksione ndaj tyre, në përpunë me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
- Administratori duhet të drejtojë e të organizojë punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare;
- Te raportoje para Asamblesë se Përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendësi te veçante përveprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- Të zbatojë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, të dhëna brenda kompetencave të përcaktuara nga statuti i shoqërisë dhe legjislacioni në fuqi;
- T'i paraqesë në mënyrë të rregullt Asamblesë së Përgjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancit dhe llogaritë vjetore brenda një afati prej tre muajsh duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar;
- Administratori ka të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”.

Dt. 20/11/2020

- Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit.
- Për përfaqësimin e shoqërisë përpara organeve administrative, gjyqësore ose të tretëve duhet firma e administratorit. Në rast pengesh, si sëmundje, aksidente, udhëtime etj, administratori do të autorizojë një person tjetër për përfaqësimin dhe administrimin e shoqërisë.

### **Neni 13 Viti Financiar**

Veprimet financiare mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa mbi nxjerrjen e bilancit të formuluar konform ligjit mbi kontabilitetin.

Është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të vendosë për krijimin e fondevë nga të ardhurat neto si dhe përdorimin e tyre.

### **Neni 14 Mbarimi i Shoqërisë**

Duke qenë se në çdo kohë për motive të ndryshme shoqëria mund të ndodhet përballë shpërbërjes Asambleja e Përgjithshme vendos për mënyrën e likuidimit të saj, në bazë të ligjeve në fuqi.

### **Neni 15 Te ndryshme**

Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky statut vlejnë dispozitat e ligjit Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, pjesa e pare mbi “Dispozitat e Përgjithshme”, pjesa e katërt për “Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar” si dhe aktet ligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

Statuti u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t'u administruar në baze te ligjit, një kopje për tu dorëzuar ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe kopjete tjera mbahen nga ortaket themelues dhe shoqëria **“AGRO IMSHTA” sh.p.k**

---

### **ORTAKET E SHOQERISE “AGRO IMSHTA” sh.p.k**

**ARDJAN ÇITOZI**

*Arsian Çitozi*

**REGONT BEQIRI**

*Regont Beqiri*

**VALTER NDRECA**

*Valter Ndreca*